VENDIM
Nr. 143, datë 26.11.2015

PËR LICENCIMIN E SHOQËRISË "C & S ENERGY" SHPK, NË AKTIVITETIN E TREGTIMIT TË ENERGJISË ELEKTRIKE

Në mbështetje të neneve 16; 37, pika 2, germa "d"; 39, pika 4, dhe 110, të ligjit nr. 43/2015, "Për sektorin e energjisë elektrike", neneve 4, pika 1, germa "g"; 5, pika 2; 13, të rregullores "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 108, datë 9.9.2008, Bordi i Entit Rregullator i Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 26.11.2015, pasi shqyrtoi aplikimin e paraqitur nga shoqëria "C & S Energy" sh.p.k., si dhe relacionin e Drejtorisë së Licencimit, të Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve dhe Drejtorisë Juridike dhe të Mbrojtjes së Konsumatorit, për licencimin në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike të kësaj shoqërie,

konstatoi se:

Aplikimi i shoqërisë "C & S Energy" sh.p.k., plotëson pjesërisht kërkesat e parashikuara nga ERE në rregulloren "Për procedurat e licencimit, modifikimit, transferimit të plotë/të pjesshëm dhe rinovimit të licencave", si më poshtë:

- Formati i aplikimit (neni 9, pika 1) është plotësuar në mënyrë korrekte.
- Dokumentacioni juridik, administrativ dhe pronësor (neni 9, pika 2) është plotësuar në mënyrë korrekte.

- Të dhënat specifike sipas tipit të licencës (neni 9, pika 4/10, germat "a", "b" dhe "c") është plotësuar në mënyrë korrekte.

Për mungesën e dokumentacionit, që ka të bëjë me:

- dokumentacionin financiar dhe fiskal (neni 9, pika 3), rezulton se vërtetimi nga tatim-taksat është në proces apelimi.

Për gjithë sa më sipër cituar, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Licencimin e shoqërisë "C & S Energy" sh.p.k., në aktivitetin e tregtimit të energjisë elektrike, për një afat 30-vjeçar, me kusht që të paraqesë në ERE menjëherë sapo të marrë vërtetimin përfundimtar të likuidimit të tatim-taksave.
2. Me plotësimin e afatit 45-ditor të sipërcituar, ky vendim do të jetë objekt rishikimi nga Bordi i ERE-s.
3. Drejtoria e Licencimit, e Monitorimit të Tregut dhe të të Licencuarve të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI I ERE-s
Petrit Ahmeti